



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 151/ Prot
13

Tiranë, më 10.3.2016

VENDIM

Nr. 03, datë 10.3.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe provave të administruara në cilësi ngarkim të kontrolluesit, **klinika "MATRIX CENTER"**, sh.p.k.,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit Nr.22, datë 08.02.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 03.02.2016, filloi procedura e kontrollit administrativ pranë kontrolluesit klinika "MATRIX CENTER" sh.p.k, me objekt kontrolli:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit klinika "MATRIX CENTER" sh.p.k., i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Nga hetimi administrativ në vend, në datë 09.02.2016 e vazhdim, pranë kontrolluesit klinika "MATRIX CENTER" sh.p.k., grupi i kontrollit konstatoi se:

1-Kontrolluesi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, me qëllim mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme, ka vendosur një sistem video-vëzhgimi CCTV, por **nuk** ka informuar (neni 18), subjektet e të dhënave, me tabela informuese mbi prezencën e këtij sistemi.

Në kuadër të garantimit të elementeve të sigurisë së përpunimit të të dhënave personale, kontrolluesi nuk ka hartuar një rregullore të veçantë për përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV.

2-Kontrolluesi **nuk** ka përmbushur detyrimin për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave, duke rënë ndesh me nenet 21-22 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". i ndryshuar.

3-Kontrolluesi, paraqiti një rregullore për mbrojtjen e të dhënave, sipas një formati të strukturuar nga një kontrollues tjetër, (UK) ku përcakton përkufizimet në përgjithësi. Kjo rregullore mbetet

fiktive, pasi në nenin 14 të saj, është parashikuar “Njoftimi”, kur njoftimi nuk është kryer ende.

4-Kontrolluesi, nuk aplikon deklaratë konfidencialiteti, e cila është detyrim për çdo punëmarrës. Parë në frymën e ligjit (pika 2/dh neni 7 dhe neni 28), kontrolluesi duhet të aplikojë deklaratën e konfidencialitetit për të gjithë punonjësit, gjë e cila do të ishte një ndër masat kryesore e cila do të garantonte privatësinë e pacientëve/klientëve të tij. Kontrolluesi, duhet të marrë masa në mënyrë që, personat që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Çdo person që vepron nën autoritetin e kontrolluesit, nuk duhet t’i përpunojë të dhënat personale tek të cilat ka akses, pa autorizim.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbal i konstatimit, i cili nuk u firmos nga kontrolluesi.

Në zbatim të neneve 87-88 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, për respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në datë 01.03.2016 është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesin e kontrolluesit, lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Kontrolluesi-klinika “*MATRIX CENTER*” sh.p.k., nuk paraqiti pretendime me shkrim, por u shpreh se: “Nuk kemi patur dijeni për Ligjin Nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Rezulton se, kontrolluesi është në shkelje të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar. Kontrolluesi ka patur gjithë mundësinë për t’u njohur me ligjin dhe detyrimet që rrjedhin nga ky ligj, dhe aktet e tjera nënligjore.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/I shkronja “dh” të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

b) “kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për informim, sipas përcaktimit në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me gjobë në vlerën 10 000 deri në 300 000 lekë.

d) “kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për njoftim, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me gjobë në vlerën 10 000 deri në 300 000 lekë.

dh) “kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masa të sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.”

Kontrolluesi, klinika "MATRIX CENTER" sh.p.k., në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me sigurinë e të dhënave personale, detyrimin për njoftim dhe informim, si një e drejtë parësore në zbatim të ligjit, dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale.

Komisioneri gjithashtu, ka parasysh faktin që kontrolluesi ka qënë në bashkëpunim serioz me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 18, 21, 27, 28, 30, 31, 39/1 shkronja "b", "d" dhe "dh", 39/2, 40 dhe 41 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

V E N D O S A :

1. Dënimin e kontrolluesit, klinika "MATRIX CENTER" sh.p.k., me gjobë, në vlerën **20 000 (njëzetmijë) lekë**, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit, klinika "MATRIX CENTER" sh.p.k., me gjobë, në vlerën **50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë**, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Dënimin e kontrolluesit, klinika "MATRIX CENTER" sh.p.k., me gjobë, në vlerën **30 000 (tridhjetëmijë) lekë**, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27, 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
4. Kontrolluesi, klinika "MATRIX CENTER" sh.p.k., të rikuperojë shkeljet e konstatuara nga grupi i kontrollit brenda një periudhe prej 30 ditësh.
5. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot në, 10 . 3 .2016

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI

Konc. S Sata
N Sulaj
Siglora A Gjylbegaj
Adresa: Rruga e Kavajës, Nd. 80, H. 1, kati 5, Tiranë.
<http://www.idp.al>

Telefon: +355 42237200
e-Mail: info@idp.a